



Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë

P r e z e n c a n ë S h q i p ë r i

**Fjala e Ambasadorit Osmo Lipponen, Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri,
në prezantimin e Analizës së Sistemit Ligjor**

19 shkurt 2004

Të dashur gazetarë, të dashur përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë,

Jam krenar që ju prezantoj sot këtu Analizën e parë të plotë të Sistemit Ligjor në Shqipëri të përgatitur nga Prezenca e OSBE-së.

Duket e lehtë kur botohet një libër, por, pas rezultatit përfundimtar, fshihet shumë punë. Unë jam gjithashtu i kënaqur që përfundimi i kësaj analize përkon me disa iniciativa të shpallura nga qeveria në fushën e reformës së shërbimit civil dhe sistemit ligjor.

Pse e kemi ndërmarrë këtë detyrë? Sepse e kemi parë se ka një nevojë reale për këtë lloj studimi dhe analize. Ka një nevojë të përgjithshme për përmirësimin e qeverisjes, veçanërisht, në pjesëmarrjen publike dhe transparencën. Nuk mund të ketë qeverisje të mirë pa patur këto cilësi në sistemin ligjor. Por, në përgjithësi, qëllimi i analizës sonë është që të informojmë lidhur me kuadrin ligjor, praktikat dhe problemet me aktorët e ndryshëm në sistemin ligjor. Ne, gjithashtu, rrezikuar që të bënim disa rekomandime për përmirësimin e sistemit ligjor.

Ne kemi gjetur shumë elemente pozitive në analizën tonë. Vihet re një përparim në dy vitet e fundit. Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka qenë më aktiv, Avokati i Popullit ka fituar një besim më të gjerë nga publiku, Shkolla e Magjistraturës ka sjellë cilësi më të lartë në emërimet në sistemin gjyqësor, vendimet e Gjykatës së Lartë po botohen më gjerësisht se pak vite më parë, dhe ky botim më i gjerë është shoqëruar me një cilësi më të mirë.

Ne shohim se ka një nevojë reale për më shumë transparencë në shoqëri dhe në sistemin ligjor, si edhe pjesëmarrjen publike në hartimin e legjislacionit. Kjo jo vetëm do të përmirësonte cilësinë e ligjeve, por ajo çka është më e rëndësishme do të thellonte demokracinë në këtë vend. Kur ligjet hartohen në mënyrë transparente, kjo do të thotë se të gjitha palët kanë patur mundësinë për të shprehur opinionin e tyre. Në këtë lloj situatë, nuk duhet të ketë kritika pas kësaj.

Ne kemi bërë, gjithashtu, një sërë komentesh lidhur me gjykatat. Nevoja për më shumë transparencë lidhet edhe me punën e gjykatave. Duhet të ketë një ndërgjegjësim më të madh të publikut lidhur me atë se si funksionojnë gjykatat dhe se si shpërndahen çështjet për gjykim. Një varietet më i gjerë vendimesh gjykatë duhen botuar. Kjo do të çojë në një cilësi më të lartë të këtyre vendimeve, si dhe përbën një aspekt tjetër në transparencën në gjykata.

Ka një nevojë për përmirësimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Me të mbaruar seancat gjyqësore, vendimi i gjykatës duhet të jetë i zbatueshëm. Aktualisht, përmbaruesit nuk janë shumë të suksesshëm në ekzekutimin e vendimeve. Ajo çka është veçanërisht problematike është që vendimet gjyqësore kundër shtetit janë ndër më të vështirat për t'u ekzekutuar. Kjo dëmton seriozisht besimin e qytetarëve tek institucionet e shtetit dhe bën që njerëzit të kenë pak gjasa të shkojnë në gjykatë për të zgjidhur çështjet e tyre.

Gjithashtu, më shumë prokurorë duhen specializuar në mënyrë që të merren me fushat komplekse të krimit (si krimin ekonomik apo krimin ndërkombëtar). Kodet e etikës për të gjithë në çdo aspekt të profesionit të juristit (gjykatës, prokurorë, noterë, avokatë) duhen zbatuar në mënyrë strikte dhe duhet të përfshijnë sanksione serioze në raste shkeljesh.

Arsimi juridik duhet të përmirësohet, ndonëse kjo do të thotë të përmirësosh në përgjithësi cilësinë e arsimit universitar, pra, nuk është vetëm një çështje e sistemit ligjor. Në veçanti, universitetet duhet të çlirohen nga dyshimi i korrupsionit. Lektorët duhet të bëjnë punë kërkimore (dhe jo të botojnë përkthime të punëve të lektorëve të huaj duke vënë emrat e tyre). Provimet në fakultete, si dhe ato për profesionin e noterit apo avokatit duhet të bazohen në aftësi të rëndësishme dhe jo thjesht në memorizimin e fakteve.

Do të veçoja një prej momenteve të analizës, do të theksoja rëndësinë e saj praktike ligjore. Ajo do të mbështesë aktivitetet e ardhshme të qeverisë dhe kjo është arsyeja pse ne po ua shpërndajmë atë instituzioneve kryesore shtetërore (gjykatave, prokurorëve, deputetëve, ministrave), si dhe universiteteve. Analiza do të jetë, gjithashtu, e dobishme për bashkësinë e donatorëve ndërkombëtarë dhe, gjatë përgatitjes së saj, disa ide të analizës u kthyen në projekte.

Analiza e Sistemit Ligjor ndodhet, gjithashtu, në faqen e internetit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri www.osce.org/albania